




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [kk.rks-gov.net/gjilan](http://kk.rks-gov.net/gjilan), [indo.gjilan@rks-gov.net](mailto:indo.gjilan@rks-gov.net) tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

## Procesverbal

I mbajtur në seancën e nëntë (IX) të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 15.7..2013 me këtë:

### REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
- 2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
  - 2.1. Raporti i punës i Kryetarit të Komunës Janar-Qershor 2013,
  - 2.2. Raporti Financiar Janar-Qershor 2013,
  - 2.3. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Gjilanit për vitin 2012.
- 3. Të ndryshme,**

Kryesuesi i Kuvendit  
Izmi Zeka

Në punimet e seancës së nëntë morën pjesë:  
Anëtarët e Kuvendit,  
Drejtorët e drejtorive  
Përfaqësuesi i OSB-së, z. Irfan Ukshini  
Përfaqësuesi për të Drejtat e Njeriut Fazli Abdullahu  
Përfaqësuesi i KVRL-së  
Mediet

Punimet e seancës së nëntë i hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës dhe të gjithë monitoruesit dhe të pranishmit e tjerë në sallë.

Ne vijim të punës, kryesuesi theksoi se rendin e punës e keni marrë dhe në KPF jemi pajtuar që të debatohen tri pika të rendit të punës, kurse disa pika të tjera në seancën tjetër e cila do të mbahet pas dy ditëve.

**1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,**

Në punimet e seancës së nënte ishin të pranishëm 39 anëtarë të Kuvendit, kurse munguan dy anëtarë (2): Sabedin Kadriu dhe Elisah Ymeri

Procesverbali

Miratohet procesverbali pa vërejtje

## **2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**

**2/1. Raporti i punës i Kryetarit të Komunës janar-qershor 2013,**

Izmi Zeka- kryesuesi i Kuvendit përkitazi me këtë pikë fjalën ia bartë kryetarit të Komunës , z. Qemajl Mustafa, sepse si pikë e parë e rendit të punës është raporti i kryetarit të Komunës për periudhën gjashtë mujore të vitit 2013.

Qemajl Mustafa- kryetari i Komunës fillimisht i përshëndeti anëtarët e Kuvendit dhe të pranishmit e tjerë në sallë dhe theksoi se ju e keni marrë këtë raport, kurse unë do të mundohem më shkurtimisht ta elaboroj këtë raport për t' i dhënë mundësi Kuvendit që ta thotë fjalën e vetë lidhur me këtë raport të punës.

Në fillim kryetari theksoi se si Komunë e Gjilanit vazhdojmë që të jemi Komunë me ambient të mirë për punë, niveli i sigurisë është i mirë, por edhe klima politike konsideroj se është jashtëzakonisht e mirë, marrëdhëniet ndër njerëzore janë të mira, por edhe në mes të komuniteteve janë të mira, por edhe në me shoqërisë civile dhe medieve janë jashtëzakonisht të mira.

Në vijim të fjalës së tij kryetari i Komunës filloi për ta sqaruar raportin e punës së tij për secilën drejtori dhe secilën zyrë, të cilat të dhëna u prezantuan edhe përmes video projektorit në sallë, por të cilin raport anëtarët e Kuvendit e kanë pasur edhe në material të seancës.

Arben Mehmeti- e përshëndes raportin e punës së kryetarit, por së pari për kryesuesin e kam një vërejtje, sepse për mua nuk është lajm dhe risi kalimi i një anëtarit të Kuvendit si zonja Leonora nga pozita në pozitë, po ashtu ka ndodhur edhe me Arianit Sllamnikun i cili ka kaluar nga pozita në pozitë do të thotë në AKR.

Sa i përket raportit të kryetarit mendoj se ka qenë një raport i cili na ka maltretuar jashtëzakonisht shumë neve si Kuvend, sepse ne dhe në të kaluarën i kemi kërkuar edhe raportet e drejtorive përkatëse, kurse sot në formën si është sjell ky raport më tepër është një prezantim elektorale në kuadër të fushatave parazgjedhore sikur që bëhen prezantimet në salla dhe sheshe të qyteteve. Gjatë tërë kohës kryetari foli vetëm për gjëra dhe ngjarje pozitive e që nuk do të duhej të jetë ashtu, sepse kryetari i Komunës duhet t' i thotë edhe

anët pozitive, por edhe të metat dhe gjërat negative, ngecjet dhe arsyet pse kanë ndodhur edhe këto gjëra.

Unë e çmoj punën e kryetarit në ato pjesë ku ka punuar në interes të qytetarëve të Komunës. Mirëpo së pari po theksoj se porsa hymë sot në këtë sallë i pamë se disa anëtarëve të Kuvendit iu kishin shlyer dhe bastarduar emrat dhe po e them me plotë bindje se kjo është në kuadër të projekteve elektorale, sepse kanë lejuar që qytetarët të hyjnë në sallë dhe të presin për nxjerrje të dokumentacionit në Administratë.

Mandej kryetari e tha se ka emëruar drejtorin e Administratës, por po ashtu edhe një të emeruar tjetër, nënkryetarin e Komunës. Kjo është risi në qeverisje administrative në nivel të Kosovës, kur është drejtori i Administratës e të cilit i bëhet edhe një bashkëkryesues i asaj drejtorie e që është vërejtje edhe e qytetarëve dhe e zyrtarëve, sepse tërë kohën, nënkryetari i Komunës është në administratë dhe në zyre të drejtorit e që është keq që e kemi këtë situatë të tillë. Është e pakuptimtë që Drejtoria e Administratës të udhëhiqet prej dy personave.

Në raportin e kryetarit nuk përmenden shumë gjëra negative të cilat janë të pranishme në këtë Komunë,. Nuk u përmend çështje e stafit që punon në Komunë të Gjilanit, sepse janë afër 30 zyrtarë e të cilat punojnë sipas sistemit të PPP-së, do të thotë Komuna e Gjilanit ka kontraktuar kompani për të dhënë shërbime shtetërore e që është një risi në nivel të Kosovës, sepse unë nuk posedoj informata se diku tjetër ka ndodhur një rast i tillë.

Po ashtu sa i përket transparencës jemi shumë larg dhe në veb faqe të Komunës nëse e shikojmë e vërejmë se nuk kemi asgjë të re në faqen zyrtare të Komunës.

Obligim është që çdo vendim dhe risi duhet të vendose në faqen zyrtare të Komunës, por kjo nuk po ndodh. Ne e kemi biseduar dhe e kemi edhe në rregullore që transmetimet e seancave të Kuvendit të vendosen në faqen zyrtare të Komunës, por as kjo nuk po ndodh dhe nuk u tha asnjë fjalë për këto fusha e do të duhej të thuhet.

Bibliotekën e përmendi kryetari, por mendoj se mungojnë angazhimet më serioze të udhëheqjes komunale për të vazhduar punët, sepse në qendër të qyteti është krijuar një shëmti dhe mos të lejohet kjo gjendje një kohë aq të gjatë.

Nga kryetari i tha se do të bëhet një park diku në drejtim të Malishevës, por nuk u tha që e kemi një park i cili ka filluar këtë vit dhe ka mbetur në gjysmë në lagjen “Arbëria”.

Në Arbëri është dëmtuar një pjesë e atij investimi dhe është një gjendje e keqe e që ka qenë desh kryetari ta theksoj në këtë raport. Po ashtu edhe në Lumin Mirusha e kemi një gjendje mjaft të rëndë, ka ndërtim në një pjesë, dëmtim në pjesën tjetër, kurse në fund është krijuar edhe një si liqe artificial në qendër të qytetit.

Kemi zbatime parciale të projekteve si është asfaltimi i rrugëve, sepse është asfaltuar një pjesë, kurse pjesa tjetër ka mbetur si është rruga në drejtim të Fakultetit “Fama.”

Kështu kanë mbetur në gjysmë, në Kamnik, në Livoçin e Poshtëm, në Kravaricë dhe kemi shumë projekte fiktive, sepse nuk janë kompletuar ashtu ai janë kontratat.

Subvencionet janë problem i veçantë i Komunës së Gjilanit 271 mijë €, kurse ne si Kuvend e kemi aprovuar një rregullore në të cilën parashihet në mënyrë specifike kushtet për t’ i dhënë dikujt mjete materiale. Një informatë të cilën na e kemi kërkuar nga drejtori dhe i cili na e ka dërguar, shihet se subvencionet më tepër realizohen në baza shoqërore, miqësore, klanore dhe politike, por jo në baza profesionale dhe në harmoni me punën e rregullores së këtij Kuvendi!

Po ashtu edhe auditori ka konstatuar shkelje të rënda në projekte dhe në bazë të raportit thuhet 1.5 milion € janë investime kapitale, por nuk u përmend se cilat saktësisht janë ato investime, a janë shlyerje e borxheve, apo janë projekte reale ?

Po ashtu është vërejtje serioze se Komuna e Gjilanit ka hyrë në marrëdhënie kontraktuese me kompani të ndryshme, sepse ka nënshkruar kontrata për pa i zotuar mjetet, prandaj edhe kjo është pjesë e vërejtjeve të auditorit.

Ndriçimi publik është në gjendje të rëndë dhe pjesë kryesore më vitale nuk kanë ndriçim publik, por dje kam qenë në vizitë në disa pjesë të qyteti dhe kam vërejt se diku ka ndriçim edhe nëpër ara për hir të ndonjë personi të fuqishëm.

Po ashtu dështim kemi edhe në mirëmbajtjen verore të rrugëve, sepse çdo ditë shihet se në çfarë gjendje janë rrugët.

Projekti i drunjve dekorativ më tepër është shndërruar në projekt privat, sepse edhe ky projekt më tepër po realizohet nga ajo pjesë ku dikush ka ndonjë interes.

Mandej është shumë shqetësuese çështje e prokurimit, sepse prej kontratave mbi 1 mijë €, janë 25.67%, kurse kontrata me ftesë për kuotim janë 42.60% të kontratave. Nga kjo shihet se buxheti është duke u menaxhuar shumë keq nga kjo qeverisje, sepse projektet realizohen me ftesa kuotimi dhe në këso raste mund ta marrim me mend se kush mund të jetë përfitues. Ju faleminderit për durim.

Leonora Bunjaku- pa marrë parasysh se si vlerëson LDK-ja, apo ndoshta është mendim personal i Arben Mehmetit, aderimi i im nga PSD- në PDK, personalisht e shoh si një e arritur e dyanshme, si nga ana ime, po ashtu edhe nga fryma demokratike në Gjilan.

Me tërë potencialin tim intelektual, por edhe fizik, unë do të kontribuoj në mbarëvajtjen dhe avancimin e çdo procesi jetësor. Iu them sinjerisht se unë do të jem pjesë bashkëpunuese për ngritjen dhe mirëqenien e dinjitetit të qytetarit.

Sokol Haziri- unë uroj që çdo lëvizje që bëhet të kalojnë mirë aty ku shkojnë, sepse kjo është dëshirë individuale e secilit për të qenë aty ku dëshirojnë, prandaj i shoh të pakuptimta temat për këto zhvillime.

Sa i përket raportit të kryetarit unë e falënderoj kryetarin për këtë raport dhe për vullnetin që pat që në mënyrë detale t' i paraqes gjërat dhe unë këtë më tepër e konsideroj si dëshirë për t' i sqaruar gjërat dhe ndoshta tendencë për të marrë kohë, sepse ka përgjegjësi për të dhënë sqarim, sepse është kryetar i të gjithë qytetarëve të Gjilanit.!

Sa i përket raportit po filloj nga arsimi dhe është për t' u përgëzuar ajo që u tha se kanë mbetur vetëm tri shkolla për ta plotësuar infrastrukturën shkollore, por janë disa gjëra të cilat nuk i ceku kryetari dhe ta vrasin syrin kur shkon me një shkollë që qyteti dhe e sheh inventarin e viteve të mëhershme ( inventar tërësisht të vjetër dhe të papërshtatshëm). Sugjerimi im është që të shikohet kjo çështje, sepse nxënësi çdo ditë rrinë në atë karrige dhe banga. Mandej duhet pasur kujdes rreth sigurisë dhe disiplinës rreth shkollave dhe këtë po e theksoj se shpesh më ka ndodhur që ta dërgoj fëmijën në Shkollën Filllore “Rexhep Elmazi”, kurse aty motoristat bëjnë gara e cila është dukuri shumë e keqe. Ka për të bërë shumë në arsim dhe duhet bërë.

Kultura dhe sporti, natyrisht se ka të arritura dhe e përshëndesim çdo të arritur, sepse i shërbejnë qytetarëve tanë, por natyrisht se ka edhe probleme e të cilat do të duhej që të ceken, sikur para Teatrit të Qytetit ku pat një problem. Një sugjerim i imi te kjo drejtori

është se tërë aktiviteti kulturo dhe sportiv nuk duhet të organizohet vetëm në qytet, por duhet edhe në fshatra të organizohet diçka nga jeta kulturore dhe sportive.

Shëndetësia, por sidomos ajo familjare ka përmirësim në mënyrë të sjelljes, por natyrisht se nevojitet më tepër disiplinë dhe do t' i sugjeroj drejtorit që të bëhet halexhi dhe të shkojë në institucione shëndetësore si një qytetarë dhe të bëhet inspektim më i shpeshtë qendrave mjekësore.

Te PPP është mirë që të bëhet një raport i anëve pozitive dhe negative të atyre investimeve që janë bërë në dy objektet që u thanë, do të thotë në mbledhjen e ardhshme të kemi një pasqyrë se cila është dobja dhe cilat janë të metat nga ky proces në mënyrë që ta japim mendimin tonë për këtë çështje.

Shërbimet publike kanë hyrë në PPP me Kompaninë "Ecohigjiena", por do të ishte mirë që në një nga mbledhjet e radhës të paraqitet një raport i punës rreth asaj se çka është arritur ose mangësitë e kësaj kompanie, sepse duam për ta ditur saktë se si janë zhvillimet dhe a kemi arritur sukses me këtë partneritet.

Kur është fjala te Shërbimet publike, duhet kryetari që të merret me disa gjëra më seriozisht, sepse ne kemi lagje ( është një e tillë që nuk ka kanalizim dhe as ujësjellës).

Është një lagjeje matanë rrugës qarkore, në drejtim të Stanishorit, është informale, por njerëzit kanë ndërtuar shtëpi dhe gjithnjë është duke u rritur dhe janë banorë halexhinj. Duhet ta kemi një shtrirje të infrastrukturës ku ende dora e pushtetit realisht nuk ka prekur.

Te Bujqësia pajtohem që janë bërë bukur drunjtë dekorativ, por sugjerimi im është që të epen më shumë donacione në fshat.

Unë po e përmbylli këtu me sugjerimin final që të punohet më shumë, sepse vërejtja se shumë projekte janë të nisura dhe të papërfunduara dhe do të dëshironim që të jenë të përfunduar në fund të këtij mandati.

Arben Maliqi- fillimisht e kam një urim për drejtorin e Administratës Mentor Mihovcin i cili para pak ditësh është emëruar drejtor nga kryetari i Komunës, por edhe një përgëzim për drejtorin e mëparshëm Arben Dubova i cili e ka bërë një punë shumë të mirë të cilit i urojmë suksese në punët e tjera. Në emër të grupit gjithashtu e përshëndesim edhe zonjën Leonaora Bunjaku e cila ka kaluar në një subjekt tjetër me dëshirën e vetë.

Gjithashtu i përgëzoj edhe qytetarët e Zhegrës me rastin e shpalljes së Zhegrës si Komunë e re e Republikës së Kosovës dhe i uroj bashkëvendësit e Idriz Seferit dhe të Agim Ramadanit që Komuna e tyre të jetë e suksesshme dhe të arrijnë rezultate të mira në çdo lëmi të jetës.

Unë e falënderoj kryetarin për këtë raport në të cilin janë prekur ato pikat më kryesore në vija të trasha, kurse unë do të përpiqem t' i them disa gjëra më kryesore.

Sa i përket Administratës e dimë të gjithë se administrata është një drejtori shumë e komplikuar, por këto ditë ka probleme edhe më shumë, sepse po ndodh edhe një proces i reregjistrimit për të cilën arsyeje po bëhet tollovi para sporteleve dhe në korridore të administratës. Në administratë duhet një angazhim më i madh, por sot po vërehet se është bërë një zgjidhje më e mirë, sepse është punuar edhe të shtunën dhe janë zgjidhur mbi 256 lëndë. Sa i përket arsimit, unë e kam thënë gjithmonë se arsimi është një problem i madh, por drejtori ka bërë një punë shumë të mirë në bashkëpunim me të tjerët. Mirëpo disa punë nuk varen nga drejtoria, por nga ministria dhe si rast i tillë është testi kombëtarë të cilin unë e

quaj test pa lidhje. Ky test nuk ka lidhje me arsim dhe sa më përket mua fare nuk kisha mbajtur test të tillë, sepse kjo mbahet vetëm sa për formalitet.

Gjimnazi i Ri do të jetë një lehtësim i madh për nxënësit e shkollës sonë, por sa i përket Bujqësisë kisha kërkuar nga kryetari i Komunës dhe drejtori i DA-së që t'ia ndërrojnë emrin dhe mos të quhet shkollë e bujqësisë. Në shkollën e re e cila i plotëson të gjitha kushtet patjetër duhet të bëhet edhe ndriçim i rrugës, sepse pa ndriçim nxënësit do të kenë probleme. Unë e kam frikën se nxënësit nuk do të regjistrohen në atë shkollë ?

Mirëpo është bërë një punë e mirë, sepse kemi inventarizim të sallave të edukatës fizike me të cilin rast kryetari i Komunës ka bërë një punë të mirë dhe kjo shkollë do t'ia plotësojë kushtet për nxënësit, por do të ndërtohen edhe disa fusha të sportit të cilat do të ndikojnë pozitivisht për ta mbajtur lëndën e edukatës fizike.

Sa i përket kulturës, rinisë dhe sportit shihet se është bërë një punë e mirë është senzibilizuar rinia, sepse po e bën një angazhim të mirë dhe është në rrugë të mbarë.

Kryetari e përmendi edhe terrenin ndihmës i cili u zgjat bukur shumë, por besoj se do të jetë një terren i mirë i cili të gjitha aktivitetet dhe klubet sportive i zhvillojnë në atë terren ndihmës dhe kështu ruhet stadiumi i qytetit.

Shëndetësia mendoj se po e kryen një punë konformë mundësive të veta dhe me mundësitë e veta drejtori po bën një punë mjaft të mirë.

Mandej me zhvillimin ekonomik, bizneset janë liruar nga taksa e cila iniciativë është një punë e madhe. Sa i përket PPP-së unë po e përmendi një projekt tek shkollat e mesme, por sa mund të realizohet sipas të gjitha gjasave nuk ka njerëz të interesuar.

Te bujqësia sa i përket drunjve dekorativ po shihen dhe si thotë fjala popullore, kjo nuk kërkon kallauzë, është bërë një punë e mirë, por e kam një vërejtje se "Dardania" është lënë anash, sepse në këtë lagje ka qenë desh dhe duhet që të mbillen drunj dekorativ.

Një rast i cili duhet përmendur për të mirë sa i përket ruajtjes së mjedisit është fshati Dobërqqan, është një fshat unikat në tërë Republikën e Kosovës. Është kënaqësi për ta parë atë fshat se çfarë rendi dhe çfarë pastërtie është. Unë e lus kryetarin e Komunës që t'ia epet një donacion fshatit Dobërqqan për tërë atë punë të mirë që po e bën. Sa i përket zyrave ato po bëjnë një punë të mirë, kurse unë në fund iu përshëndes dhe nuk duhet të kënaqemi me këto gjëra, sepse ka edhe shumë mangësi, por në bashkëpunim pozitiv dhe opozitiv duhet ta bëjmë një punë të përbashkët në dobi të qytetarëve të Komunës së Gjilanit.

Sadudin Berisha- kujtoj se fjala e kryetarit të Komunës lidhur me raportin e punës për gjashtë mujorin e parë me anë të pozitive dhe ato negative, ka mund të përmbledhet me 30-40 minuta e jo për dy orë të tëra e të cilat mendoj se më tepër janë marketing politik, për gjëra të cilat janë paraqitur në raportin përfundimtar për vitin 2012.

Unë po i theksoj disa shqetësime të cilat nganjëherë Kuvendi i Komunës jo që po futet në lajthitje, por po futet në një situatë jo të këndshme.

Unë përmend ndërrimi i pronës, por thjeshtë u përmend ndërtimi i Qendrës Rinore me mjete të cilat i ka lejuar Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport në shumë prej 500 mijë € e që do të ndërtohet në hapësirën që është këmbyer në me ministrisë përkatëse dhe Qendrës për Punësim. Ne e dimë se kjo përbërje e Kuvendit ka dhënë pëlqimin për këmbim të pronës, por jo të ndërtohet aty Qendra për Rini, sepse është në kundërshtim me Planin rregullues urban të qytetit e që do të thotë prejudikohet ridestini në atë pjesë i një Qendre Rinore. Sigurisht donacionin që është dhënë e mbështesim, por ai objekt duhet të ndërtohet në hapësirat e

planifikuara më parë, nëse është planifikuar, por ne nuk kemi informacion se ka një planifikim të tillë!

Së dyti u përmend inkasimi i taksave për ndërtim (është fjala për taksa për ndërtim të lartë). Ndryshimet të cilat kanë ndodhur për taksa për ndërtim edhe të ulët dhe të lartë e bëjnë të pamundur realizimin e objektivave që ka marrë Qeveria Komunale për inkasimin e taksave jo në dhënie të lejes së ndërtimit, por në dhënie të pëlqimit të ndërtimeve e që nuk është leje e ndërtimit. Është marrë një rekomandim nga këtu që taksat ndërtimore të paguhen në faza dhe në fund t'epet leje e ndërtimit. U tha nga kryetari se ata ndërtimtarë që kanë marrë pëlqimin për ndërtimin e lartë t' i paguajnë obligimet e tyre të taksave për ndërtim sipas vendimit të mëparshëm. Unë po e theksoj se një gjë e tillë nuk mund të realizohet, sepse ky Kuvend ka marrë një vendim të paligjshëm për ndërtim të objekteve vetëm me pëlqimin urbanistik e që është në kundërshtim me ligjin dhe një gjë e tillë nuk mund të realizohet në asnjë mënyrë që ata ndërtimtarë t' i paguajnë obligimet e tyre me taksat e vendimeve të mëparshme. Kjo do të thotë se përgjegjësitë e kësaj Komune kur veprojnë kundërligjshëm humbin të gjithë dhe mbi të gjitha interesat e qytetarëve.

U përmend çështja e funksionimit të “Eco-Higjienës” e cila ka një PPP që ka dal si rezultat i vendimeve të këtij Kuvendi, por ky Kuvend ka nxjerr një vendim për themelimin e komisionit për mbikëqyrjen e marrëveshjes në mes dy partnerëve.

Deri më sot asnjëherë nuk është ftuar ai komision për të nxjerr një vlerësim se sa është realizuar marrëveshja e paraparë në mes dy partnerëve. Për këtë arsyeje nuk mund të thuhet se është ky rezultat apo ai rezultat për derisa ai komision nuk është takuar nuk ka nxjerrë një vlerësim të tillë se sa është realizuar shkalla e obligimeve në mes dy partnerëve.

U përmend fusha e bujqësisë në të cilën lëmi nuk jam profesionistë se 59m<sup>3</sup> dru janë konfiskuar, përderisa thuhet se janë paraqitur 148 fletëparaqitje. Nëse kemi fletëparaqitje dhe ato kryesisht për prerje ilegale të pyllit së paku 1 m<sup>3</sup> çdo person e ka pasur e do të thotë se ka anomali të ndryshme. Monografia u tha nga vetë se është një projekt i dështuar e që ne kemi thënë edhe në debate publike se një Monografi e tillë nuk është në të mirën dhe interesin e qytetarëve të Gjilanit.

Dhe në fund po theksoj se kemi harruar se çka kemi thënë para katër viteve në fushatë si parti në pushtet se ne do t' i ndërtojmë arteriet hyrëse në katër anët e qytetit, kurse sot minimizohet skajshmërisht se nuk është e rëndësishme ajo! Është desh të ndodh ka qenë interes, por jo nuk është e rëndësishme!

Arianit Sllamniku- gjatë debatit emri im është lakuar nga Arben Maliqi dhe Arben Mehmetit për aderim dhe kalim në parti tjetër, por mos ta bajë këtë askush këtë dert, sepse Arianiti me Lëvizjen për Integrim, do të jetë sa AKR-ja me numra në mandatin e ardhshëm dhe nëse kjo nuk realizohet unë do të largohem nga obligimet politike. Këtë premtim po e jap publikisht.

E dyta çështja e kontributit në shkollë u tha te inventari, unë po e jap këtë në një ndërlidhje me emrin tim e që janë 6 klasë në Shkollën “Musa Zajmi” e që do të vetëfinancohen nga prindërit dhe komuniteti turk, gjegjësisht Qeveria Turke me iniciativë time dhe të subjektit të cilin e përfaqësoj.

Te raporti më bërë përshtypje vetëm një pikë dhe çdo gjë ishte reale nga raporti i kryetarit, por çështja e institucionit “Don Bosko”. Kjo çështje institucion arsimor, AIT-i shkollë e mesme, gjimnaz etj, por e cila operon në një pronë e cila ka konflikt pronësor në institucionet ligjvënëse. E dyta institucioni i cili nuk kisha pasur dëshirë të dëgjohet nga krerët e komunës

sonë që të bëhet një digresion i njëjtë me institucionet arsimore publike të Komunës siç ishte Shkolla e Mesme Teknike, prandaj institucioni “Don Bosko” ka të bëjë edhe me çështje të tjera të cilat sot e kemi një presion ndaj familjes së Qemajl Jasharit i cili ka preson të hapur nga e njëjta strukturë e atij institucioni.

Unë vetëm këtë vërejtje e tërhoqa, kurse për çështje ambientale dhe të kolektorëve ishte në risi dhe freski e përmbylljes së raportit të kryetarit.

Ramiz Ramdani –nga raporti i kryetarit po ndalem te projektet e zhvillimit ekonomik, sepse u tha diçka për studimin e fizibilitetit për zonën e Novo Bërdës. Ajo që mua më intereson është se cili është interesi i Komunës së Gjilanit për këtë zonë?

Mendoj se Komuna e Gjilanit si një qendër regjionale duhet të angazhohet të bëhet zonë ekonomike e Gjilanit dhe jo e Novo Bërdës.

Te pjesa e bujqësisë nuk besoj që ka ndonjë praktikë në botë që raportimin e bënë me numër të fermerëve, me shifra e të cilat për mua është vështirë për t’i elaboruar. Ja një shembull: furnizimi i fermerëve me foli plastike, kanë përfituar 173 fermerë! Çka është kjo e rëndësishme? Mendoj se për neve si Kuvend është e rëndësishme për ta ditur cila është vlera nominale e këtij projekti, kurse sa kanë përfituar do të jetë pjesë shtesë e të dhënave? E njëjta gjë ndodh edhe te mbjelljet pranverore, te bletarët, makinat mjelëse etj.

E tërë kjo mendoj se ndodh për shkak se janë vlera të ulëta dhe sipas të dhënave në përgjithësi del se i kemi pasur 78 mijë € subvencione dhe 3 projekte janë në vlerë deri në 10 mijë €. Mandej te grandet e Ministrisë së Bujqësisë, nuk duhet të fokusohemi në tërësi në këtë ministri, sepse mandej nuk paraqitet gjendja reale, por për më keq këtu janë prezantuar subvencione për mbjellje të grurit, por për cilën periudë ka ndodhur kjo, sepse ne po flasim për raportin gjashtë mujor janar - qershor 2013.

Te drunjtë dekorativ thuhet se këtë vit janë mbjell 369 drunj e që në vlerën që e prezantoi kryetari është diçka mbi 63 € për një dru dhe në përgjithësi del se janë diku mbi 24 mijë €. Në raportin e Drejtorisë për Financa i kam parë 78 mijë €, subvencione 7 mijë e 500 € shpenzime kapitale e të cilat nuk i di cilat janë, kurse nuk i shoh askund këto 24 mijë €.

Kjo po na e krijon konfuzitetin edhe pse mendoj se çmimi 65 € nuk është shumë i lirë, por duke e marrë parasysh edhe mirëmbajtjen e të tjera nuk mund ta marrim edhe si çmim shumë të lirë.

Në sektorin e pylltarisë duhet të jeni të saktë në shifra, të thuhet se janë konfiskuar 59m<sup>3</sup> dhe janë lëshuar 148 fletëparaqitje është mospërputhje e shifrave.

Saranda Bllaca- sa i përket raportit të kryetarit lidhur me sferën e arsimit fatkeqësisht konsideroj se është një raport i mangët, ka vetëm disa statistika të thjeshta dhe nuk është shumë i zbërthyer. Raporti i kryetari është paraqitur vetëm në gjashtë slljade për DKA-në.

Në këtë raport unë e pashë një sllajd ku është paraqitur sukcesi i nxënësve në fund të gjysmë vjetorit të parë, kurse mungon raporti për përfundimin e vitit shkollor. Pasi që raporti është gjashtë mujor ka qenë e panevojshme të paraqitet sukcesi i gjysmë vjetorit të parë dhe pse nuk është sjell sot sukcesi i nxënësve në fund të vitit shkollor.

Janë përmendur ndërtime të shkollave të cilat nuk i përkasin këtij raporti gjashtë mujor, mandej është përmendur edhe hapja e Universitetit të Gjilanit siç duket vetëm për ta mbushur sllajdin, por siç duket sot u hoq nga sllajdi.

Kryetari e tha se arsimi në Gjilan është më i miri në Kosovë, unë po e theksoj se nuk e keni vërejt mirë, sepse unë po e theksoj se arsimi përgjithësisht në Kosovë, por në veçanti në

Komunën e Gjilanit edhe përkundër përpjekjeve për t' u përmirësuar përsëri është me defekte. Viti shkollor përfundoi, ne nuk kemi të dhëna, por kemi informacione se kemi rezultate jo të mira, probleme jo të vogla, premtime të mëdha dhe projekte të parealizuar. Ende ka shkolla të cilat nuk kanë përfunduar mësimin, mësimi zhvillohet në tri ndërrime, ora e mësimit zgjat 30 minuta dhe në shkolla të mesme të larta në çdo klasë i kemi mbi 30 nxënës dhe ka raste ku në një klasë ka deri në 40 nxënës.

Ende ka mungesë të inventarit nëpër shkolla, kemi mungesë të kabineteve, por sidomos mungesë të kabineteve të informatikës. Kemi mungesë të sallave të edukatës fizike, kemi shkolla me kushte jashtëzakonisht të rënda dhe po i përmendi dy si Pogradit dhe Zhegër, shkollën e vjetër të cilat objekte janë demotivuese si për nxënës, por edhe personel arsimor. Mirëpo kemi informacion se në shkollë të Pogradit, asnjëherë nuk është bërë vizitë nga DKA. Sa i përket testit të maturës, është një sukses shumë i fryrë, sepse kalueshmëria në afatin e qershorit është 71.58% e që dallon shumë nga vitet e kaluara. Ne mendojmë se duhet të ndryshohet mënyra e mbajtjes së këtij testi, të mbahet në formë elektronike në mënyrë që të bëhet vlerësimi real i nxënësve.

Shqetësimi i madh është mos luftimi i dukurive negative nëpër shkolla si janë rrahjet, therjet me thikë, pirja e duhanit, përdorimi i substanca narkotike. Këto dukuri jo vetëm që nuk luftohen sa duhet, por ato janë edhe në rritje. Mandej krahas nevojave për investime kapitale për zgjerimin e hapësirave, pajisjeve teknike, laboratorëve, fushave sportive etj, nuk mund të lihen anash edhe rritja e pagave për mësimdhënësit për t' i përmirësuar kushtet për zhvillim të procesit mësimor.

Po ia kujtojmë Drejtorisë dhe kryetari se 22 mësimdhënësit ende nuk i kanë marrë disa paga e të cilët mësimdhënësit janë pranuar me konkurs të rregullt.

Në fund po theksoj se arsimi është një sferë shumë e gjerë dhe me sfida dhe mendoj se jemi larg nga ajo që e dëshirojmë.

Shpresa Kurteshi- në raportin gjashtë mujor të punës nga sfera e kulturës përsëri nuk kemi ndonjë raport për manifestimin e “Flakës së Janarit” as në komitet dhe as në Kuvend.

Kjo dukuri po përsëritet vazhdimisht, por edhe këtë vit edhe pas gjashtë muajve ka mbetur e mbyllur dhe ende nuk e dimë koston financiare se sa ka kushtuar ky manifestim në tërësi.

Mandej sipas raportit thuhet ka pasur dha ka bashkëpunim dhe përkrahje të OJQ-ve dhe ansambleve në Komunë, por kjo mund të jetë pjesërisht e vërtetë, por jo në tërësi, sepse sipas informacioneve dhe kontakteve që i kemi ka të tillë që fare nuk e kanë gëzuar këtë përkrahje për arsye që ndoshta vetëm drejtoria i dinë.

Gjithashtu janë mbajtur edhe disa trajnime dhe udhëtime studimore jashtë vendit me studentë të rinj, por është me interes për neve dhe opinionin publik ta dimë se për çka bëhet fjalë? Sa studentë kanë udhëtuar dhe çfarë aktivitete kanë pasur?

Njësia për të Drejtat e Njeriut për të cilën njësi e lexova në raport se çka duhet të bëjë kjo njësi, do të thotë përshkruhet vetëm ajo se çka duhet të bëjë, mirëpo nuk ka informacione për atë se çka ka bërë? Sipas mendimit tim kjo është vetëm një përshkrim dhe në asnjë mënyrë raport. Te Barazia Gjimore nuk ka ndonjë statistikë për të arriturat e gruas në pozitë vendim-marrëse që është bërë fal reagimit të njësisë apo të zyrtares për barazi gjimore. Nga kjo nënkuptohet se nuk ka pasur ndonjë lëvizje në këtë drejtim dhe heshtja e zyrtares për barazi gjimore për gjendjen aktuale në përgjithësi dhe për mos zbatim të ligjit për barazi gjimore le shumë për të dëshiruar.

Jehona Hyseni- unë do të përqendrohem në këtë raport tek të dhënat e DKRS-së, sepse e pamë nga raportimi i kryetarit se edhe përkundër aktiviteteve vjetore të cilat janë të parapara me këtë raport nuk ekzistojnë raportet për manifestimet më të rëndësishme si për “Flakën e Janarit”, “Betejën e Zhegocit”, “Ditët e Agimit”, Ditët e Çlirimit dhe aktiviteteve të tjera. Fatkeqësisht edhe përkundër problemeve shumë të mëdha që kanë këta sektorë si rinia, kultura dhe sporti, Drejtoria për Kulturë dhe komiteti përkatës si trup e Kuvendit në periudhën gjashtë mujore janar –qershor ka mbajtur vetëm një mbledhje dhe atë me një pikë të vetme të rendit të punës.

U tha edhe nga kolegja se manifestimi “Flaka e Janarit” “ ka filluar në heshtje dhe ashtu ka mbetur, sepse që nga ajo kohë nuk kemi pasur ndonjë raport financiar as ne si anëtarë të këtij komiteti. Në të njëjtën mënyrë kanë kaluar edhe manifestime e tjera të cilat u përmendën nga kolegja. Duhet theksuar se për disa manifestime janë ndarë mjete të konsiderueshme, manifestimi kulturor “Ditët e Agimit” që zgjati tri ditë injorohet tërësisht dhe është përkrahur në mënyrë vetëm simbolike, kurse neve na është desh që të kërkojmë donatorë të tjerë për këtë manifestim tradicional. Unë mendoj se manifestimi “Ditët e Agimit” duhet të futet në program vjetor të drejtorisë me buxhet të paraparë dhe të trajtohet në mënyrë të dinjitetshme. Lidhur me infrastrukturën rrugore unë në emër të banorëve të Zhegërës, LLadovës dhe Nasalës kërkoj një përgjigje se kur do të fillojnë punimet për asfaltimin e kësaj rruge?

Mandej një shqetësim tjetër i banorëve të Zhegërës është se kërkojnë të zhvendoset në shenjë komunikacioni e cila është vendosur në drejtim të Shtëpisë së Shëndetit, Stacionit Policor dhe shkollës fillore, shenjë e cila ndalon lëvizjen e automjeteve në këtë drejtim.

Abdyl Aliu- raporti përmbledhës i punës- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik – po theksoj se sikur ta lexonte këtë raport ndonjë shtetas gjerman, zviceran, apo i ndonjë shteti të zhvilluar ai do të kërkonte që të vijë dhe jetojë në Gjilan! Mirëpo në çastin që të kishte ardhur në Gjilan mund të merret me mend se çka do të kishte parë!

Ne kemi pasur takim në Komitetin për Zhvillim Ekonomik e kam thënë se shprehi dëshirën që Drejtoria për Zhvillim Ekonomik të punojë me të vërtetë për zhvillim ekonomik dhe jo vetëm ta plotësojë vetëm një apetit të dikujt sa për t’ u bërë drejtor ose të hapet ndonjë vend i punës në atë drejtori. Drejtori në atë kohë ka pas treguar shumë gatishmëri për bashkëpunim, por ajo gatishmëri u vërtetua se ka qenë vetëm deklarative, sepse prej themelimit drejtori me komitetin përkatës është takuar vetëm njëherë e gjysmë! Fjalët e kryetarit për zhvillim ekonomik janë të mira, por nuk janë në harmoni me gjendjen aktuale, sepse që nga themelimi i kësaj drejtorie më tepër ka mbyllje të vendeve të punës se punësime të reja, ka bankrotime të bizneseve më shumë dhe në përgjithësi ka rritje të skamjes dhe varfërisë.

Ato pak mjete që po i ka Komuna e Gjilanit po shpenzohen për t’ i shlyer borxhet, kurse shlyerje borxheve nuk gjeneron vende të reja të punës. Lidhur me PPP-në në veçanti për dy objektet e ndërtuar nuk qëndron ajo se kemi pasur dobi shumë nga PPP si Komunë dhe si publik, por sherrin është vërtetë se ia kemi parë. Te të hyrat për periudhën janar –qershor ka qenë desh të hyjnë edhe të hyrat nga PPP, do të thotë nga shitja e këtyre dy objekteve.

Te Drejtoria e Bujqësisë te të hyrat janë dy shifra shumë të ulëta, do të thotë hyrjet janë realizuar 16%, kurse te koncesioni 22% . Çka nuk funksionon këtu? Planifikimi ka dështuar apo nuk ka qenë planifikimi i mirë?

Arzie Nuhiu- raporti i kryetarit të Komunës për të gjitha sektorët ishte real dhe kryetari prezantoi suksese vërtetë të arritshme në Komunën e Gjilanit. unë e kam vetëm një pyetje

për zonjushën Sarandë se nëse i ka të identifikuar rastet e therjeve të nxënësve në shkollat e Komunës së Gjilanit do të ishte mirë të na i konkretizoj. Ne e dimë që nga organet e sigurisë nuk ka ndonjë raport të tillë, prandaj nëse nuk ka raste nuk do të ishte mirë që zonjusha të merret me atë propagandë, sepse vetë është mësimdhënëse.

Saranda Bllaca- unë punoj në arsim dhe ne javën e kaluar grupi i këshilltareve komunale i kemi bërë një vizitë zyrtare Gjykatës Themelore në Gjilan dhe jemi takuar me kryetarin e kësaj gjykate dhe sipas tij numri i nxënësve që pësojnë nga therjet është në rritje e sipër. Mandej kemi pasur raste që ka vdekur njeri në kafiteri, por në shkollën ku punoj i di rastet që ka rrahje që ka edhe therje, por unë jam edhe anëtare e komisionit disiplinor dhe për këso raste kemi larguar edhe nxënës nga shkolla. Raste të tilla ka pasur edhe në Gjimnaz, prandaj nuk duhet shtruar pyetje të paarsyeshme, por duhet zonjusha Arzie të ketë informacione nga dora e parë.

Bujar Nevzadi- unë që nga pas lufta jam anëtar i KK-së dhe këtë që po e thotë zonjusha Sarandë nuk ka ndodhur në Kosovë, por as në Gjilan! Kryetari i tha gjërat shumë saktë, shumë thjeshtë dhe shumë transparent të gjitha aktivitetet e Komunës. Nuk është e vërtetë dhe nuk qëndron ajo se ka pasur therje në shkollat e Gjilanit. Nuk kam asnjë rast nga qytetarët dhe mësimdhënësit së paku që 3.5 vjet që unë jam drejtor i Arsimit që ka deklaruar dikush se në shkollat e Gjilanit ka ndodhur edhe vetëm një therje.

Unë nuk kam këso informata, por iu lus juve si Kuvend dhe i lus qytetarët që të na informojnë nëse një therje ka ndodhur në shkollat e Gjilanit.

Unë nuk po flasë se çka ndodh nëpër rrugë, mëhalla, por po flas për nxënësit e shkollave gjatë orarit të mësimi. Saranda është anëtare e Komitetit të Arsimit dhe ne jemi takuar çdo muaj dhe aty e ka pasur mundësinë të bëjë pyetje dhe sugjerime. Nuk qëndron ajo se në shkollën e Pogradjës DA nuk e ka vizituar dhe të lus mos të merresh me të pavërteta.

Është e vërtetë se jemi një ndër komunat më të mira, por a jemi aty ku dëshirojmë me siguri jo, por çdo vit ka avancime.

Ejup Haziri- unë i përshëndes të gjithë, por e kam një lutje që të procedojmë më shpejtë të jemi më racional në procedura, sepse nëse vazhdojmë kështu të paktën Kuvendit në Gjilan t' i vendosim edhe një mbiemër dhe ta quajmë "Kuvendi i pa vend"!

Jashar Jashari- unë do të ndalem në sferën e shëndetësisë dhe u tha se QKMF i ka 284 punëtorë, mjekë, infermier, teknik të ndryshëm dhe punëtorë të tjerë. Është një numër për lakmi, por e kam një pyetje për kryetarin e Komunës se a është në dijeni se si funksionon Shërbimi i kabinetit të rëntgenit i cili shërbim ka vetëm një teknik të rëntgenit i cili e mban vetëm një ndërrim dhe për ndërrimin e radhës shërbimit i vihet dryni. Kjo anomali nuk është vetëm për këtë gjashtë mujor, por kjo po zgjat me vite. Pse në këtë shërbim nuk pranohet edhe një punëtor kur ka mundësi? Mandej pse nuk respektohet orari i mbajtjes së kujdestarive në qytet gjatë ndërrimit të natës? Ka kohë që kjo marrë veshje është shkëputur. Në fund përkundër premtimeve nga drejtori i QKMF-së se do të bëhet ndërrimi i dritareve në Punktin shëndetësor të Pogradjës e cila kërkesë është bërë para dy vite siç po shihet nuk do të realizohet as në gjashtë mujorin e dytë të këtij viti!

Bahrie Veseli- në këtë raport të këtij gjashtë mujori në sferën e arsimit ka mangësi dhe ka shumë gjëra të cilat nuk janë përmendur si është dëmtimi i shkollave të cilën informatë nuk e kemi fare. Disa rrugë janë asfaltuar dhe kanë përfunduar punët finale si në Lagjen e Tetë, por nuk është rregulluar rruga e cila shkon në drejtim të shkollës, të cilin shqetësim unë e kam ngritur disa herë në emër të banorëve të Lagjes së Tetë. Rruga që shkon për në shkollë është një rrugë qorre dhe nxënësit dhe qytetarët kanë shumë probleme për të shkuar deri në shkollë.

Qemajl Mustafa- ne jemi në sallë të KK-së dhe jemi duke e shqyrtuar raportin gjashtë mujor të punës dhe është normale që dikush qasjen e ka politike dhe e ka në funksion të marketingut e cila gjë është e drejtë. Mirëpo ka edhe të tillë që e kanë qasjen plotësisht profesionale dhe do të ishte mirë që të jetë kjo e fundit. Është gjë normale që nga opozita të mos lavdërohen këto raporte dhe informacione, sepse atëherë opozita do ta zbehte rolin e vetë dhe nuk presim duar trokitje, por do të duhej një qasje shumë realiste ndaj punëve të cilat i prekim çdo ditë.

Raporti ka qenë maltretues e tha Arbeni, por po e them se qasja e ime për këto vite ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë jo konsumim i kohës ose maltretim i këtij Kuvendi dhe i strukturës sime qeverisëse për të fituar në kohë ndonjëherë.

Ajo që e keni në raport është një pjesë e vogël e zhvillimeve të cilat kanë ndodhur dhe ndodhin në terren në të gjitha fushat e punës dhe të jetës. Ju nëse i merrni raportet detale të drejtorive dhe analizoni mirë, atëherë do të bindeni se në këtë raport nuk janë të evidentuara edhe gjysma e punëve të tjera. Unë jam ndalur te makro zhvillimet dhe jam munduar t'ia paraqes Komunës proceset dhe nuk qëndron ajo që nuk i thash edhe të meta, i thash të metat më të mëdha, por edhe ndonjë ngecje që e kemi identifikuar së bashku me drejtoritë dhe juve dhe nuk hezitoj asnjëherë për t'i thënë, por nëse është ndonjë e metë personalisht e imja unë e posedoj këtë sens dhe di për të kërkuar falje.

Ne në një debat me qytetarë kemi qenë plotësisht të hapur me qytetarë, këtë plotësisht duhet ta ngulitni në mendjen e juaj, sepse në çdo kohë në zyrën time ka qenë në çdo kohë dera e hapur për të marrë informacione, për t'ia qas, por edhe për të qëndruar për ditë të tëra për të bërë studim dhe askush për këtë periudhë askush askujt nuk ka guxuar t'ia thotë jo!

Drejtori i Administratës është i ri, sepse drejtori i mëparshëm ka shkuar, kurse drejtorit të ri, por unë nënkryetarit i kam dhënë obligime që krahas detyrave të tjera për ta monitoruar procesin në Administratë dhe për ta orientuar këtë proces. Përgjegjësit tjetër Kujtim Bajrami i kam dhënë obligim që 70% të jetë në Administratë, vetëm e vetëm që qytetari të shërbehet në mënyrë kualitative dhe me kohë.

U tha nga dikush se nuk u përmenden aspektet negative sidomos në sektorin e Inspeksionit, por i thash unë ato gjëra se nuk është ai sektor të cilin unë e dua, sepse do të duhej për t'ia dhënë mësim drejtorive të caktuara të cilave ai iu shërben si Shërbimeve Publike, Urbanizmit etj. Mirëpo është larg më mirë se sa që ka qenë, sepse ishte anarki dikur.

Kontrata për dhënie të shërbimeve (blerja e shërbyesve civil), ne kemi diskutuar për këtë çështje njëherë dhe nuk ka nevojë të kthehemi edhe njëherë dhe e kam sqaruar rregullsinë e lidhjeve të kësaj kontrate.

Informacionet me dije time i keni në faqen e Komunës dhe nuk ka akt të cilin nuk e pasqyron faqja e Komunës dhe të gjitha aspektet i keni atje, me përjashtim që mund të ketë ndonjë vonesë një ditore.

U përmend Biblioteka Regjionale dhe mos angazhimi i Komunës për të vazhduar punimet, por së pari Arbeni duhet lavdëruar Komunën për të ndodhur nisma e bibliotekës, për t'u vënë guri i themelit, sepse ky angazhim ka zgjat së paku 1.5 vite ose edhe më tepër për të krijuar kushte për të ndodh një investim i tillë. Fillimisht kërkesë e KE ka qenë për ta ndërtuar administratën Komunale në Gjilan, por në mungesë të lokacionit e që dihet është e planifikuar ku është aktualisht Burgu i Qarkut, unë kam bërë luftë të jashtëzakonshme që ai investim mos të ik nga Komuna, por të mbetet në një prioritet dhe i kam bindur pasi që kanë parë gjendjen e rëndë hapësinore në Bibliotekën Rajonale. Ngecja është në relacion në mes të investitorit të KE dhe punë kryesit dhe kjo nuk ka të bëjë asgjë me kryetarin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës. Është shkëput kontrata me atë punë kryes dhe tash vazhdon procesi.

Në të njëjtën mënyrë është edhe çështja e stadiumit i cili po zvarritet, por ka filluar.

U përmend, parku në Arbëri, por ai do të përfundojë tash, sepse me rishikim të buxheti Qeveria na i ka ndarë edhe 1 milion € dhe investohet me këtë milion. Këtë milion që vjen do ta shpërndajmë në projektet më prioritare si Lumi Banja duhet të finalizohet, Kodra e Dëshmorëve duhet të finalizohet, një pjesë, duhet të paguhet te rruga "Halim Orana", rruga për Kravaricë dhe kështu me radhë. Do të thotë këtë milion do ta harxhojmë te projektet që i kemi filluar dhe kanë mbërri deri në 50, 60 ose 70% dhe kërkohet edhe një pjesë e investimeve.

U tha se ka disa projekte se kanë filluar dhe nuk kanë përfunduar, kjo është e vërtetë, por për mua është me rëndësi që kanë filluar edhe me rrezikun që publiku të na kritikojë dhe nga pak edhe të na përgojë, por unë me njerëzit e mi kam shkuar dhe jam takuar me qytetarë dhe i kemi dhënë shpjegimet e duhura dhe përpiqemi çdo ditë që investimet t' i përfundojmë.

Lumi Mirusha është në këtë funksion dhe është guxim i veçantë ne i kemi hyrë dhe kemi arrit te 50% i projektit. Sot aty ku janë duke u kryer punimet është pikërisht 50% i punës së kanalizimit, por ende ka punë në humanizim të shtratit, por po vazhdojmë në drejtim të 2 mijë metrave tjera, sepse te 2 mijë metra kemi mbërri.

Te subvencionimet të cilat u përmenden ka shumë keqkuptim dhe kemi bërë një negociim me auditorin dhe atë për një kohë të gjatë dhe me rregullore është që subvencionimet të jepen vetëm etje ku me rregullore nuk janë të destinuara. Atje ku KK ka përcaktim paraprak se si duhet se si duhet të shpenzohen subvencionimet është totalisht naive dhe e pakuptimtë të kthehemi te KPF dhe të debatohet se ku do të shpenzohet paraja e Teatrit. Dihet saktë se 100 mijë € i ka Teatri dhe vetëm Kuvendi dhe komiteti e ka për obligim për t' i monitoruar se ku janë shpenzuar. Është thënë shumë qartë se 30 mijë € shkojnë për artet muzikore, është thënë qartë se 10 mijë € shkojnë për rini etj.

Te Auditimi e kemi pikën tjetër, por mua më intereson se kualifikimi është pozitiv dhe është viti i tretë që Auditori i Përgjithshëm Komunën e Gjilanit e kualifikon në superlativ për nga mënyra se si i udhëheq pasqyrat financiare dhe si i barazon me qeverinë dhe si arsyetohen në raporte të hyra dhe të gjitha shpenzimet. Bazuar në këtë kualifikim pozitiv, Komuna do ta ketë të drejtën të marrë kredi dhe huamarrje për ambiciet e saja zhvillimore. Nëse dy vitet e fundit Auditori një komunë nuk e kualifikon pozitivisht nuk do të ketë të drejtë as të diskutohet për të marrë kredi dhe huamarrje. Vërejtje ka, por ato janë normale, sepse nuk ka asgjë prefekte.

U fol për mirëmbajtjen e rrugëve verës dhe dimrit, por është një aspekt që po çalon dhe këtë e kam thënë shumë herë, sepse ne e kemi shpall në prill përfituesin dhe unë e kam kryer punën time, Komuna e ka përfunduar sa i përket aspektit ligjor dhe moral dhe të konkurrencës. Pse kompanitë bëjnë gara ne mes veti, pse kanë gjet lidhje në OSHP për të manipuluar

njerëz dhe njëri tjetrit për t'ia marrë punën është çështje e tyre dhe është e dhimbshme. Është mungesë e qëndrueshme në atë hierarkinë e qeverisjes në Kosovë në përgjithësi.

Mandej u përmend nga Arbeni se aty ku i kanë shtëpitë keni bërë ndriçim dhe drunjt dekorativ dhe infrastrukturë tjetër, por po e them se nëse ndonjëherë ka ndodhur qasje e përkushtuar për ta trajtuar meritueshëm dhe barabarsishtë qytetarin e Komunës, atëherë është me të vërtetë kjo qeveri! Kurrë nuk më ka interesuar si kryetari i Komunës i të gjithëve cila mëhallë më ka dhënë mua votën, cila nuk më ka dhënë votë. Asnjëherë nuk më ka interesuar cila lagje apo fshat e ka votuar më tepër PDK-në apo ndonjë parti tjetër. Shembull të tillë më ilustrativ se Pogradjën nuk kemi. Në Pogradjë më 2007, 51% ka fituar LDK-ja, por në atë periudhë kanë ndodhur investime të bujshme në Pogradjë. Nuk e kemi bërë këtë për ta rrit bilancin, por i kemi identifikuar bashkë nevojat të cilat kanë qenë në Pogradjë.

Sa i përket pyetjes së Jehonës, për rrugën LLadovë-Nasalë, tenderi do të shpallet më datë 23 ose 24 të këtij muaji dhe shpresoj se në fillim të muajit tjetër mund të kemi përfitues dhe lëvizje në terren.

U pyet për drunjtë dekorativ, por kjo është nonsens, sepse këta drunjt janë në arteriet kryesore të qytetit dhe janë për të gjithë qytetarët dhe një pjesë të vogël i kemi mbjell edhe në ambientet shkollore ose në ambiente të shëndetësisë (Spitalin Regjional).

U bë pyetje për ftesat për kuotim, por iu lus se te këto ftesa mos u bazoni në numër dhe ajo përqindja që është në sllajd është gabuar dhe unë vazhdimisht e kam tërheq vërejtjen që mos të paraqitni këso lloj përqindje. Ajo është numri i akteve, por nëse e marrim vëllimin e parave që janë harxhuar te ftesat për kuotim është minor.

Për arsim u thanë shumë gjëra, por është një pjesë e madhe e inventarit i cili është i degraduar, sepse Qeveria është orientuar me pajisje inventarizim të ri të shkollave të reja, por në të njëjtën kohë ka pasur mundësi të merret edhe me ato të vjetrat.

Jam për atë që të bëhet një raport vetëm për investimet kapitale, të cilin edhe do ta bëjmë.

Bujqësia kurrë nuk ka pasur më shumë subvencione dhe investime, por a do të duhej më shumë me siguri se po, kurse Shkollës së Bujqësisë kemi marrë iniciativë për t'ia ndërruar emrin dhe me sa e di unë do të quhet Shkolla e Agrobiznesit dhe e Teknologjisë si është përvetësuar në Kosovë një emërtim i tillë.

Sa i përket terreneve sportive, çdo vit ka pasur investime për sport dhe rekreativitet, fusha sportive të jashtme, salla sportive, renovime. Ato nuk janë shumë, por janë çdo vit dhe unë do të dëshiroj që sivjet të jetë salla e gjashtë. Unë e kam menduar secilin vit nga një sallë për ta ndërtuar edhe atë së pari në qytet, pastaj në fshatra.

Shkurtimisht ishin përgjigjet e mia, por unë kam edhe shënime të tjera dhe jam në gjendje të përgjigjem në detaje edhe më të vogla. Ju falënderoj për mirëkuptim.

Sadudin Berisha- faleminderit kryesues, por po e theksoj se po përsëritet ajo që e thash, sepse vërtetë një çështje e cila mund të thuhet për 10-15 minuta këtu po na mbahet ligjëratë.

Është një maltretim sërish po e them dhe nuk u përgjigj në pyetje konkrete që ne i bëmë kryetarit të Komunës? Pse Komisioni për mbikëqyrje të Eco-Higjienës nuk thirr dhe nuk ka asnjë vlerësim dhe për këtë duhet të epet një raport i jashtëzakonshëm.

Çfarë do të ndodh me taksat e papaguara për lejet ndërtimore që janë dhënë jo me leje ndërtimi, por me pëlqim, kur kemi ndryshim të tarifës. U tha se do të inkasojmë ajo realisht është e pamundur, cila është përgjigja?

Po theksoj se çështjet më të rëndësishme nuk preken dhe bishtnohet që të preken nga kryetari i Komunës dhe për këtë arsyeje kujtoj se më tepër është një maltretim.

Qemajl Mustafa- unë nuk i bishtno asnjë të vetme çështje z. Sadudin! Unë po dëshiroj të jap shpjegime maksimalisht dhe nuk e di cila ishte çështja të cilën e fsheha ta thotë një z. Sadudini?

Sadudin Berisha- kërkoja të epet përgjigje pse nuk thirret komisioni për mbikëqyrjen e marrëveshjes së PPP-së në mes KK-së dhe Eco –Higjiensë?

Çfarë do të ndodh me taksat komunale që janë paraparë në faza të pagesës për leje jo të ndërtimit, por pëlqime të cilat janë dhënë pa leje të ndërtimit, për derisa kemi ndryshim të tarifës së re të taksave për 30% nga ajo që ka qenë më parë.

Qemajl Mustafa- Qendra Rinore është e jona , ajo është e rinisë ajo duhet të vendoset diku dhe dot ë vendoset vetëm aty ku ka tokë dhe nuk mund të vendoset në pronë private, sepse nuk kemi para për ta shpronësuar pronën. Qendra Rinore është vendos të ndërtohet aty ku ka tokë, hiqet objekti i vjetër dhe ndërtohet qendra.

Taksat për ndërtimin do të paguhet me të vjetrën të gjitha taksat për objektet të cilat i kanë filluar punimet dhe ato që kanë hyrë në marrëdhënie kontraktuese me Urbanizmin.

Vetëm prej ditës kur të merret vendimi këtu e tutje, çdo lej urbanistike që lëshohet në ditët që vijnë i nënshtrohet regjimit të ri të taksave.

Eco –Higjena është aspekt ligjor sa i përket edhe pjesës publike edhe të PPP. Raporti vjen këtu dhe ai është vjetor, sipas ligjit në fuqi ai është vjetor. Mirëpo kur të dëshironi ju edhe para vitit e biem raportin për të sqaruar se si po shkon ai partneritet Kjo është e hapur, mandej është edhe Komisioni i aksionarëve i cili është i votuar prej këtij Kuvendi.

Te fletëparaqitjet më duket e imtë ajo qasje, kur thuhet se janë 146 fletëparaqitje për prerje të pyjeve dhe 59m<sup>3</sup>. Mirëpo fletëparaqitje nuk i dërgohet vetëm atij i cili gjendet me m<sup>3</sup> dru dhe në flagrancë, por i dërgohet secilit i cili ka hyrë në pyll me sëpatë për të prerë dru.

Kam plotë argumente që pyjet e Gjilanit janë pyje më të dinjitetshëm të ruajtura në hapësirën e Kosovës dhe këtë pohim mund ta vërtetojmë edhe në gjykatë, por edhe në Agjensionin Kosovar të Pyjeve.

Kryetari e përfundoi fjalën e tij edhe me disa sqarime më të hollësishme përkitazi me arsimin dhe në fund i falënderoi të gjithë anëtarë e Kuvendit dhe të pranishmit e tjerë në sallë.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi i Kuvendit kërkoi nga anëtarët e Kuvendit që të deklarohen se kush është për aprovim të Raportit të punës së kryetarit.

Aprovohet pika 2/1 e rendit të punës: Raporti i punës i Kryetarit të Komunës janar-qershor 2013, me 19 vota të anëtarëve të Kuvendit, 13 ishin kundër, 4 abstenime.

Me këto diskutime seanca e nëntë i përfundoi punimet, sepse ishte një seancë e cila zgjati 4 orë e 30 minuta, kurse pika 2/2 dhe 2/3 do të shqyrtohen në seancën e dhjetë pas dy dite më datë 17.7.2013

Procesmbajtësi

---

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

---

Izmi ZEKA